

**KËSHILLI I BASHKISË
K O R Ç Ë**

VENDIM

Nr 19 Datë 25.3.2010

***PËR NIVELIN E TARIFAVE VENDORE PËR FAMILJARËT DHE
ADMINISTRIMIN E TYRE NË QYTETIN E KORÇËS PËR VITIN 2010***

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme pasi morri në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave, bazuar në Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” neni 35 dhe në Ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” Ligjin nr 9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr 24 datë 02.09.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI :

Të miratojë nivelet e tarifave vendore për familjarët dhe administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës për vitin 2010 si më poshtë vijon :

- Tarifë pastrimi për çdo familje **1.250 lek në vit**
- Tarifë ndriçimi për çdo familje **500 lek në vit**
- Tarifë gjelbërimi për çdo familje **350 lek në vit**

Tarifat e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit që i përkasin kategorisë “çdo familje”, prej muajit Janar 2010 detyrimi vjetor në lidhje me këto tre tarifa do të shpërndahet për periudhën Janar 2010 – Korrik 2010 të vitit 2010 dhe do të paguhet së bashku me faturën mujore të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, pranë sporteleve të Ujësjetës Kanalizime Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Gjergji PENDAVINJI

